



Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, 26.10.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.10.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Bashkimi Meti”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rkonstruimi i rrugës Isa Kastrati”, me Nr. të Prok: 616 20 126 521 nxjerr:

VENDIM

1. **[Aprovohet]** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “Bashkimi Meti” të dt. 23.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “ Rkonstruimi i rrugës Isa Kastrati”, me Nr.616 20 126 521 ,kundër *[Njoftimit për dhënie të Kontratës]* te AK –së, të datës 22.10.2020 te publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. **[Anullohet]** vendimi i AK për *[dhënien e kontratës]* të publikuar me datë: 22.10.2020;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *[aktivitetin e Prokurimit të ktheje ne Rivlersim]*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim


Operatori Ekonomik "Bashkimi Meti" me datë 23.10.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rikonstruimi i rruges Isa Kastrati" me Nr. të Prok: 616 20 126 521 .Autoriteti Kontraktues, me datë 26.10.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ak ka konstatuar, se në certifikatën e biznesit ceket se bëhet fjalë për të njëjtën Kompani , përveq se është shëndrruar në "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar " dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit